



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

01 Nr.819/2026
29.06.2026

KRYETARI / PRESEDNIK / MAYOR

<https://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038 200 438 14

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008 dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë si dhe Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, bënë:

TAKIM PUBLIK

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT PËR GJASHTË MUJORIN E PARË JANAR – QERSHOR 2026

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Istogut, OJQ-të, grupet e interesit dhe palët e tjera të interesuara, se Kryetari i Komunës së Istogut, Ilir Ferati, organizon takimin e parë publik me qytetarë për punën e tij për periudhën, **Janar – Qershor 2026**.

Takimi publik mbahet më datë: **16.07.2026 (e enjte)**, në orën **10:00**, në **Sallën e Kuvendit Komunal në Istog**. Në këtë takim do të keni mundësi të njiheni me punën e qeverisë komunale për gjashtë mujorin e parë të vitit 2026 dhe zhvillimet aktuale në Komunë.

Po ashtu qytetarët pjesëmarrës në takim mund t'i bëjnë pyetje dhe komente ekzekutivit të Komunës për të gjitha temat të cilat atyre u interesojnë.

Jeni të mirëpritur!

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI